

Përmbledhje

Sistemi financiar në vend u karakterizua me dinamikë të përshpejtuar të rritjes edhe gjatë TM1 2019, rritje që kryesisht u mbështet nga rritja e asetëve të sektorit bankar dhe atij pensional.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, sektori bankar u karakterizua me rritje të aktivitetit kreditues, performancë të kënaqshme financiare si dhe nivel të favorshëm të indikatorëve kyç që matin shëndetin e sektorit. Asetet e sektorit bankar u rritën për 45.2 milionë euro në TM1 2019, kryesisht si rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues dhe rritjes së investimeve në letra me vlerë. Rritja e aktivitetit kreditues përgjatë periudhës raportuese i'u atribuua ofertës së lehtësuar dhe kushteve të favorshme të kreditimit, si dhe kërkesës së rritur për kredi.

Aktiviteti kreditues u mbështetet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat deri në fund të TM1 2019 përfaqësonin 80 përqind të gjithë detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit. Në tremujorin e parë, depozitat u rritën për 19.1 milionë euro, kryesisht si rezultat i zgjerimit të depozitave të ekonomive familjare, ofertë e ndikuar nga oferta e favorshme e aplikuar nga bankat përmes rritjes së normave të interesit në depozita.

Në kuadër ofertës kreditore, kushtet e kreditimit u përmirësuan edhe më tej përmes zvogëlimit të kostos së financimit. Në tremujorit e parë 2019, norma mesatare e interesit në kredi zbriti në nivel prej 6.7 përqind. Në të njëjtën periudhë, norma e interesit në depozita shënoi një rritje vjetore dhe arriti në një mesatare prej 1.5 përqind.

Dinamikat në afarizmin e sektorit ndikuan që performanca financiare e sektorit bankar gjatë këtij tremujori të jetë pozitive, edhe pse më e ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit pararak. Më konkretisht, në profit më të ulët kontribuoi rritja e shpenzimeve prej 11.2 përqind, kryesisht nga shpenzimet e jo interesit (shpenzimet për provizione) dhe atyre të interesit (shpenzimet e interesit në depozita dhe huamarrje). Përderisa, rritja vjetore e arkëtimeve, që reflekton kryesisht rritjen e të

hyrave nga interesi, veçanërisht në kredi, rezultoi të jetë 8.5 përqind.

Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar u përmirësua tutje, duke regjistruar nivelin më të ulët të kredive joperformuese që nga gjysma e dytë e vitit 2010, në 2.6 përqind dhe duke siguruar mbulueshmëri të kënaqshme të kredive joperformuese me provizione prej 158.3 përqind. Për më tepër, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (17.1 përqind) dhe niveli i likuiditetit (36.1 përqind) sugjerojnë që sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj rreziqeve potenciale që mund të shfaqen.

Sa i përket performancës së sektorit pensional, kthimi bruto nga investimet arriti vlerën më të lartë të regjistruar që nga fillimi i funksionimit, si rezultat i kushteve të favorshme në tregjet e jashtme. Ndërsa, sektori i sigurimeve performoi me rezultat pozitiv financiar, mirëpo më të ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit pararak. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në dinamikat e sektorit të sigurimeve ishin rritja më e lartë e shpenzimeve për dëmet e ndodhura dhe shpenzimeve operative, pavarësisht rritjes së primeve bruto të shkruara.

Sektori mikrofinanciar ka vazhduar të zgjeroj aktivitetin, e karakterizuar me rritje të theksuar të asetëve, si rezultat i rritjes së theksuar të aktivitetit kreditues dhe deri në një masë të lizingjeve. Ky sektor vazhdon të ketë performancë financiare të kënaqshme dhe nivel të ulët të kredive me probleme.

Ecuria e tregut të brendshëm të instrumenteve financiare reflekton kërkesat për financim nga Qeveria e Kosovës dhe kërkesat për investim nga institucionet bankare dhe jo-bankare në këto instrumente të sigurta e me kthim të favorshëm. Gjatë këtij tremujori, vlera e letrave me vlerë të emetuara, e dominuar nga fletë-obligacionet qeveritare që kanë maturitet mbi 2 vite, ishte më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	i
Sistemi Financiar	5
Sektori Bankar	5
Asetet	5
Performanca e sektorit bankar	11
Sektori pensional	13
Sektori i sigurimeve	14
Performanca e sektorit të sigurimeve	15
Sektori mikrofinanciar	15
Asetet	15
Performanca e sektorit mikrofinanciar	18
Tregu i letrave me vlerë	19

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës	05
Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar	05
Figura 3. Struktura e asetëve të sektorit bankar në tremujorët përkatës	06
Figura 4. Vlera e gjithsej kredive dhe dhe kategorive kryesore	06
Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike	07
Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake	07
Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore	08
Figura 8. Struktura e depozitave gjatë periudhës raportuese	08
Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita	09
Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	09
Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik	09
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare	10
Figura 13. Norma e interesit në depozitat	10
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve	10


Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare-----	11
Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar -----	11
Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar-----	11
Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	12
Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	12
Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	12
Figura 21. Asetet e sektorit pensional -----	13
Figura 22. Struktura e aseteve të FKPK-së -----	13
Figura 23. Struktura e aseteve të FSKP-së -----	14
Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së-----	14
Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	14
Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara-----	15
Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	16
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	16
Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik -----	16
Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar-----	17
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	17
Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	17
Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	18
Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	18
Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar-----	19
Figura 37. Shuma e ofruar dhe e emetuar-----	19
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë-----	19
Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës -----	19
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	21

SHKURTESAT:


APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
ËEO	Ëorld Economic Outlook

Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 6.51 miliardë euro në fund të TM1 2019, që përkon me një rritje vjetore prej 10.3 përqind (figura 1).



Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 190.2 milionë euro. Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend, pasuar nga sektori pensional (figura 2).



Zgjerimi i aktivitetit kreditor të sektorit bankar u mbështet kryesisht nga rritja e depozitave, ndërsa aktiviteti i sektorit pensional u mbështet prej kthimit të kënaqshëm nga investimet.


Sektori Bankar

Sektori bankar gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të lartë të aktivitetit kreditor, i ndikuar pozitivisht nga oferta kreditore dhe kërkesa për kredi. Përmirësimi i kushteve të ofruara për depozita nga ana e bankave, forcuan pozitën financuese të aktivitetit kreditor. Sektori vazhdoi të jetë mirë i kapitalizuar dhe likuid, përkundër fitimit neto lehtësisht më të ulët në raport me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Asetet

Në TM1 2019, asetet e sektorit bankar u rritën për 45.2 milionë euro duke kontribuar në vlerën e stokut të asetëve prej 4.23 miliardë euro në fund të periudhës. Rritja e përgjithshme e asetëve të sektorit bankar i atribuohet dinamikave pozitive të kreditimit, aktivitet që u mbështet si nga kërkesa e rritur për kredi, ashtu edhe nga oferta e lehtësuar e bankave përmes ofrimit të kushteve më të mira për kredidhënie edhe pse në një masë më të vogël. Përgjashtuar paranë e gatshme dhe bilancin me bankat komerciale, të gjitha kategoritë e asetëve shënuan rritje gjatë TM1 2019 (figura 3).

Figura 3. Struktura e asetëve të sektorit bankar në tremujorët përkatës



Duke vazhduar trendin rënës të tremujorëve të njëjtë të viteve paraprake, paraja e gatshme e mbajtur në trezor të bankave u tkurr për 51.5 milionë euro ndërsa, bilanci me BQK-në që përbën rezervat e bankave të mbajtura në BQK, u zgjerua për 38.6 milionë euro.

Bilanci me bankat tjera u zvogëlua për 26.5 milionë euro krahas rënies prej 9.3 milionë euro në TM1 2018, ku stoku i tyre zbriti në vlerën prej 314.3 milionë euro në fund të periudhës.


Në TM1 2019, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar arriti në vlerë prej 436.3 milionë euro, duke u zgjeruar për 6.0 milionë euro. Ishin investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja prej 13.3 milionë euro më tepër që ndikuan rritjen stokut të letrave me vlerë, ngase investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës janë tkurrur për 12.1 milionë euro krahas tremujorit paraprak.

Kreditë

Aktiviteti kreditues vazhdon të karakterizohet me rritje të theksuar edhe gjatë TM1 2019. Në fund të periudhës së cekur, stoku i kredive arriti vlerën prej 2.82 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.4 përqind. Vetëm gjatë TM1 2019, kreditë u rritën

për 68.6 milionë euro, krahasuar me rritjen për 48.7 milionë euro në TM1 2018 (figura 3).


Figura 4. Vlera e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore



Ndikim pozitiv në rritjen e kredive aktive gjatë TM1 2019 kishin kreditë e reja të lëshuara si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Ofertat më të favorshme bankare, shprehur përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit si për ndërmarrjet edhe ekonomitë familjare ndikuan në rritjen e gjithë stokut të kredive aktive deri në fund të periudhës së cekur. Gjithashtu, rritja e kërkesës për kredi nga të dy kategoritë, rezultoi në rritje të përgjithshme të aktivitetit kreditues.

Stoku i kredive për ndërmarrje është rritur për 52.2 milionë euro gjatë tremujorit të parë, duke arritur vlerën prej 1.80 miliardë euro (figura 4). Në baza vjetore, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve tjerë ekonomik u karakterizua me zgjerim të përsheptuar, me përjashtim të kreditimit ndaj sektorit të tregtisë i cili u karakterizua me ngadalësim të rritjes.

Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike



Kategoria e shërbimeve tjera u rrit për 14.4 milionë euro, pasuar nga zgjerimi i sektorëve të prodhimit dhe ndërtimit me rritje prej 14.2 milionë euro, përkatësisht 9.2 milionë euro (figura 5). Me gjithë ndikimin e sezonalitetit dhe dinamikave me të cilët karakterizohen sektor të ndryshëm ekonomik në periudha të ndryshme, sektorët e lartpërmendur kishin rritje më të lartë edhe krahas tremujorit paraprak. Kreditë e reja për ndërmarrje arritën vlerën në 172.9 milionë euro gjatë TM1 2019, prej të cilave 108.5 milionë euro ishin kredi të destinuar për investime, kurse 60.9 milionë euro për qëllime jo-investive. Sa i përket sektorëve ekonomik, kreditë e reja për sektorin e bujqësisë arritën vlerën prej 4.4 milionë euro, një rritje prej 0.7 milionë euro kundrejt TM1 2018. Po ashtu, rritje shënuan edhe kreditë e reja të destinuar për industrinë të cilat ishin për 5.9 milionë euro më të larta dhe stoku i tyre arriti vlerën prej 48.5 milionë euro. Përderisa, kreditë e reja për sektorin e shërbimeve u zvogëluan për 8.9 milionë euro, duke rënë në vlerën prej 102.5 milionë euro.


Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM1 2019 u shtuan për 16.6 milionë euro, duke arritur vlerën e

stokut prej 1.02 miliardë euro në fund të periudhës (figura 4). Sa i përket kredive të reja për ekonomitë familjare, në këtë tremujor është evidentuar rënie për 13.9 milionë euro, gjë që rezultoi në vlerën e përgjithshme të shënuar në TM1 2019 prej 125.0 milionë euro (138.9 milionë euro në TM1 2018). Kjo rënie u reflektua më shumë tek kreditë e reja konsumuese, të cilat u zvogëluan për 16.6 milionë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Njëkohësisht, kreditë e reja hipotekare të lëshuara arritën vlerën prej 25.4 milionë euro, apo 2.3 milionë euro më e lartë krahasuar me TM1 2018.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 80 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake. Në këtë tremujor, rritja e nivelit të depozitave për 19.1 milionë euro rezultoi të jetë zhvillim pozitiv krahasuar me rënie prej 20.5 milionë euro në TM1 2018 (figura 6). Stoku i depozitave arriti vlerën prej 3.38 miliardë euro në fund të TM1 2019.

Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake



Kategoria e burimeve vetanake u karakterizua me rritje për 21.3 milionë euro në TM1 2019 (19.0 milionë


euro rritje gjatë TM1 2018) dhe stoku i tyre arriti në 517.9 milionë euro, që kryesisht reflekton dinamikat në fitimin e mbajtur nga periudhat paraprake.

Ndërsa, kategoria e cila shënoi rënie të theksuar gjatë këtij tremujori ishte ajo e bilancit nga bankat tjera, që u zvogëlua për 37.0 milionë euro, rënie që kryesisht reflekton zvogëlimin e huazimeve apo linjave të ndryshme kreditore nga bankat jashtë vendit, përkatësisht bankat amë. Në fund të TM1 2019, stoku i bilancit me bankat komerciale zbriti në vlerën prej 69.6 milionë euro (76.0 milionë euro në TM1 2018).

Depozitat

Zhvillimet në kuadër të depozitave të sektorit bankar në TM1 2019 i atribuohen kryesisht ecurisë pozitive të depozitave të ekonomive familjare, përderisa ecuritë në depozitat e ndërmarrjeve kontribuuan në një ritëm më të ulët të rritjes. Depozitat e ndërmarrjeve u tkurrën për 46.8 milionë euro në këtë tremujor, duke ndikuar që stoku i tyre të zbret në vlerë prej 825.5 milionë euro në fund të periudhës raportuese (figura 7).

Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM4




Kjo dinamikë reflekton tkurrjen e depozitave të transferueshme të ndërmarrjeve që sygjeron alokimin e mjeteve të tyre në projekte me kthim më të lartë financiar.

Në anën tjetër, depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 61.3 milionë euro në këtë tremujor, dhe stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti vlerën prej 2.39 miliardë euro në fund të periudhës së cekur (figura 7).

Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u zvogëluan për 6.2 milionë euro në TM1 2019 (figura 8), dhe stoku i tyre zbriti në vlerë prej 2.00 miliardë euro në fund të periudhës. Ndërsa, depozitat e afatizuara u rritën për 10.5 milionë euro (stoku i tyre arriti vlerën prej 892.1 milionë euro). Poashtu, edhe depozitat e kursimit u rritën për 14.7 milionë euro, duke arritur stokun në vlerë prej 483.9 milionë euro.

Figura 8. Struktura e depozitave gjatë periudhave raportuese




Për dallim nga periudhat paraprake, ofrimi i kushteve më të volitshme të ofruara nga ana e bankave kundrejt kthimit nga depozitat rezultoi në ndryshime pozitive në strukturën e depozitave të sektorit bankar. Zgjerimi

i pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara në gjithsej depozitat e sektorit kundrejt tkurrjes së depozitave të transferueshme (megjithëse në masë të ulët), mund të rezultojnë në reduktim të rrezikut që mund të vie nga mospërputhjet e maturitetit në mes të aseteve dhe detyrimeve.

Normat e Interesit¹

Në TM1 2019, niveli i normës së interesit në kredi u zvogëlua për 0.2 pikë përqindje, përderisa norma e interesit në depozita u rrit për 0.3 pikë përqindje. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u zvogëlua në 5.3 pikë përqindje në periudhën raportuese (5.8 pikë përqindje në TM1 2018) (figura 9).

Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2019)


Normat e interesit në kredi

Gjatë tremujorit të parë, norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve qëndroi në nivel të ngjashëm në

krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, më konkretisht në mesataren prej 6.6 përqind (figura 10).

Kategoria e kredive për qëllime investive dhe kredive me kushte favorizuese patën normë më të lartë të interesit krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, 6.7 përqind, dhe 2.8 përqind përkatësisht. Përderisa, normat e interesit për kreditë jo-investive u zvogëluan në 6.6 përqind.


Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2019)

Normat e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë dhe të industrisë u rritën në mesataren tremujore prej 7.5 përqind dhe 7.0 përqind, përkatësisht.

Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2019)

¹ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

Ndërsa u zvogëluan në kreditë për sektorin e shërbimeve deri në nivelin mesatar prej 6.5 përqind dhe sektorët e tjerë në nivelin 6.3 përqind (figura 11). Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare që nga fillimi i themelimit të sektorit bankar janë duke përcjellur në vazhdimësi trendin rënës. Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme duke qëndruar mesatarisht në nivelin prej 5.9 përqind, kurse për kreditë konsumuese u zvogëluan në mesatarisht 7.0 përqind (figura 12)..

Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit




Burimi: BQK (2019)

Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita vazhduan trendin rritës të vitit paraprak. Norma mesatare e interesit në depozita prej 1.5 përqind gjatë TM1 2019 rezultoi të jetë për 0.3 pikë përqindje më e lartë se në TM1 2018 (figura 13).

Normat e interesit në depozitat për ndërmarrjet vazhdojnë të jenë më të larta krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare. Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit u rrit për 0.6 pikë përqindje në nivel prej 2.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Figura 13. Norma e interesit në depozita



Burimi: BQK (2019)

Kjo rritje pasqyron rritjen e normës së interesit në depozitat e afatizuara e cila ishte 2.1 përqind, dhe rritjen e lehtë në depozitat e kursimit deri në 0.4 përqind. Përderisa ato të transferueshme mbeten në nivel të ngjashëm me periudhën paraprake në 0.01 përqind (figura 14).

Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive




Burimi: BQK (2019)

Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare u rrit për 0.2 pikë përqindje dhe arriti në 1.3 përqind (figura 15). Kjo rritje pasqyron rritjen e normës së interesit në depozitat e afatizuara të cilat arritën në 1.3 përqind dhe të kursimit që arritën në 0.3 përqind. Norma e interesit në depozitat e transferueshme ishte e ngjashme me periudhën paraprake në nivelin

mesatar tremujor prej 0.001 përqind. Rritja e normës së interesit në depozita përbën nxitje për ekonominë për alokimin e mjeteve të tyre drejt instrumenteve me afat maturimi më të gjatë duke krijuar njëkohësisht financim më stabil për sektorin bankar.

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2019)

Performanca e sektorit bankar

Përkundër rritjes së të hyrave të sektorit bankar gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, profiti më i ulët i realizuar i'u atribuua kryesisht rritjes më të lartë të shpenzimeve të sektorit.

Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2019)

Vlera e profitit të realizuar rezultoi të jetë për 0.6 milionë euro më e ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, duke zbritur në 19.1 milionë euro (figura 16).

Të hyrat e sektorit bankar u karakterizuan me rritje vjetore prej 8.5 përqind, kryesisht si rezultat i performancës në të hyrat nga interesi (kryesisht nga kreditë dhe letrat me vlerë), por edhe rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet në kuadër të të hyrave nga jointerеси (figura 17).

Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2019)

Në anën tjetër, vlera e shpenzimeve të sektorit bankar në TM1 2019 shënoi rritje prej 11.2 përqind krahasuar me tremujorin të njëjtë të vitit paraprak (figura 17). Rritja e shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve të jo interesit, më konkretisht rritjes së shpenzimeve nga nënkategoria e provizioneve për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë, të cilat arritën në vlerë prej 6.1 milionë euro nga 3.5 milionë euro në TM1 2018. Ndërsa në kuadër të shpenzimeve për interesa, rritje shënuan kryesisht shpenzimet për interesa të depozitave të afatizuara si pasojë e rritjes së kostos së financimit të tyre. Përdërisa, kategoria e shpenzimeve


**Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar
Nr. 26, Tremujori I/2019**

administrative dhe të përgjithshme qëndroi e ngjashme me TM1 2018 në nivel prej 25.6 milionë euro.

Si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave në TM1 2019 u rrit në 69.8, që nënkupton se për çdo 1 euro të arkëtuar sektori bankar shpenzon 0.698 euro, vlerë kjo më e lartë për 1.7 pikë përqindje.

Rrjedhimisht, pozicioni financiar i sektorit bankar në TM1 2019 u reflektua negativisht edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimin në mesataren e asetëve (KMA) edhe kthimin në mesataren e kapitalit (KMK). Saktësisht, KMA u zvogëluar për 0.2 pikë përqindje në 2.1 përqind, ndërsa KMK u zvogëluar për 1.1 pikë përqindje në 17.0 përqind (figura 18).

Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Shënim: Në kalkulim të KMA dhe KMK profiti për tremujorin përkatës është analizuar Burimi: BQK (2019)

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me përmirësim të kualitetit të portfolios kreditore bazuar në rënien e mëtutjeshme të nivelit të kredive joperformuese dhe përmirësimit të mbulueshmërisë së tyre me provizione.


Figura 19. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur Burimi: BQK (2019)

Niveli i kredive joperformuese në fund të TM1 2019 zbriti në 2.6 përqind, që paraqet një rënie prej 0.3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 19).

Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur Burimi: BQK (2019)

Rënia e nivelit të kredive joperformuese deri në fund të tremujorit të parë ndikoi që raporti prej 158.3 përqind i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione të jetë për 3.2 pikë përqindje më i lartë se në fund të tremujorit të parë të vitit të kaluar. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të TM1 2019 qëndroi në nivel prej 17.1 përqind (figura 20).

Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rritje në


fund të TM1 2019 për 0.2 pikë përqindje kundrejt TM1 2018 si rezultat i rritjes më të lartë të mjeteve likuide se sa i rritjes së detyrimeve afatshkurtra. Ky indikator qëndroi në nivel prej 36.1 përqind. Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në nivel prej 83.5 përqind dhe tejkaloi lehtësisht nivelin e rekomanduar nga BQK prej 80.0 përqind, si rezultat i rritjes së përshpejtuar të aktivitetit kreditor kundrejt rritjes së financimit të tij.

Sektori pensional

Performanca e suksesshme e sektorit pensional në këtë tremujor u realizua nga kthimi i lartë i investimeve dhe rritja e arkëtimeve të kontributeve të reja.

Sektori pensional është sektori i dytë për nga pesha e rëndësisë në sistemin financiar, që përbën 27.9 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në vend.

Figura 21. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2019)

Gjatë TM1 2019, vlera e aseteve të menaxhuara nga sektori pensional u zgjeruan për 10.9 përqind duke arritur në vlerën prej 1.82 miliardë euro, dinamikë e përcjellur kryesisht nga performanca e investimeve jashtë vendit. Megjithatë edhe investimet në

instrumente financiare në tregun e brendshëm kanë sjellë kthime të favorshme për sektorin pensional, që njëkohësisht përfaqëson investuesin kryesor në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Figura 22. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM1 2019)




Burimi: FKPK (2019)

Kushtet më të favorshme investuese në tregjet e jashtme bënë që FKPK të rritë vlerën e investimeve në fonde të përbashkëta për 199.0 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u shtuan për 45.9 milionë euro. Poashtu, edhe investimet në certifikata të depozitit dhe paraja e mbajtur në BQK u rritën për 0.5 milionë euro përkatësisht 4.0 milionë euro (figura 22). Si rezultat, gjatë TM1 2019, FKPK arriti të shënoi kthim pozitiv nga investimet prej 95.9 milionë euro, vlerë rekorde e realizuar gjatë një tremujori, për dallim nga humbja e theksuar që u regjistrua në tremujorin e katërt të vitit 2018 (figura 24).

Investimet e aseteve të FSKP janë të diversifikuara kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga obligacionet e Qeverisë së Kosovës dhe të qeverive të huaja (figura 23). FSKP realizoi kthim pozitiv bruto nga investimet prej 573.5 mijë euro (107.9 mijë euro në TM1 2018).


Figura 23. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM1 2019)



Burimi: FSKP (2019)

Arkëtime të reja të sektorit pensional gjatë TM1 2019 arritën vlerën prej 44.5 milionë euro, që paraqet rritje prej 9.2 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Në kontributet e arkëtuara, 99.7 përqind i përkasin FKPK-së.

Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK (2019)


Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, rritje të primeve të shkruara dhe performancë pozitive financiare.

Asetet e sektorit të sigurimeve gjatë TM1 2018 janë rritur për 5.2 milionë euro (figura 25) ndërsa vlera e stokut të aseteve të sektorit deri në fund të marsit

arriti në 181.0 milionë euro (rritje vjetore prej 3.1 përqind).

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2019)


Gjatë këtij tremujori, kategoria e depozitave në bankat komerciale shënoi rënie të theksuar, për 3.6 milionë euro, përdërisa paraaja e gatshme si dhe depozitat e mbajtura në BQK shënuan rritje për 0.8 milionë euro. Në kuadër të investimeve në letrat me vlerë, letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim u shtuan për 0.9 milionë euro, ndërsa ato në dispozicion për shitje u zvogëluan.

Ecuria e gjithsej aseteve të sektorit reflekton zhvillimet në sektorin e sigurimeve 'jo-jetë', që përbën 90.8 përqind të aseteve të sektorit. Asetet e kompanive të sigurimit 'jo-jetë' u rritën për 4.8 milionë euro gjatë këtij tremujori ndërsa të sigurimit 'jetë' u rritën për 0.4 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM1 2019 arriti në 21.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.2 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 96.1 përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara, vlera e e të cilave arriti në 21.0 milionë euro (e rritur për 2.5 përqind). Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi 'jetë'

u karakterizua me rritje vjetore prej 21.5 përqind duke arritur vlerën në 858.7 mijë euro.

Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) u rritën për 0.3 milionë euro në këtë tremujor, dhe arritën vlerën prej 12.4 milion euro (12.1 milionë euro në TM1 2018). Rritja më e lartë e primeve të shkruara krahasuar me rritjen e dëmeve të paguara, ndikoi në përmirësimin e lehtë të raportit dëme/prime, që zbriti në 57.0 përqind nga 57.2 përqind sa ishte në tremujorin e parë të vitit paraprak (figura 26).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 shënoi rezultat pozitiv financiar, edhe pse më të ulët për dallim nga TM1 2018, si pasojë e rritjes më të lartë të dëmeve të ndodhura dhe rritjes vjetore të shpenzimeve krahas rritjes së të hyrave.

Të hyrat neto nga primet shënuan rritje vjetore prej 6.2 përqind, përdërisa në të njëjtën periudhë, dëmet e ndodhura si dhe shpenzimet operative u karakterizuan me rritje prej 7.7 përqind, respektivisht 7.4 përqind

krahasuar me TM1 2018. Shpenzimet për dëmet e ndodhura rezultuan nga rezervat më të larta të paguara për dëmet e raportuara. Rritja e shpenzimeve operative ishte rezultat i rritjes së shpenzimeve administrative për 0.5 milionë euro..

Indikatorët e pozitës së likuiditetit të sektorit u zvogëluan në periudhën raportuese. Si rezultat i rënies vjetore të stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 1.6 përqind kundrejt rritjes së rezervave teknike prej 4.7 përqind, raporti në mes tyre zbriti në 93.5 përqind nga 99.5 përqind në mars 2018. Gjithashtu, treguesi tjetër i likuiditetit që është raporti i parasë së gatshme e ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 83.1 përqind, nga 87.3 përqind sa ishte në mars të vitit të kaluar, si rezultat i rritjes së detyrimeve prej 3.5 përqind.


Sektori mikrofinanciar

Rritja e theksuar e aseteve të sektorit për të katërtin vit me radhë u mbështet nga rritja e portofolit kreditor, si dhe aktivitetit të lizingut. Ky sektor vazhdon të ketë performancë pozitive financiare dhe nivel të ulët të kredive me probleme.

Asetet

Sektori mikrofinanciar ishte sektori me rritjen më të lartë të stokut të aseteve në kuadër të sistemit financiar në tri periudhat e fundit (mars 2017 – mars 2019). Pështja e këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar megjithëse në rritje të vazhdueshme vazhdon të mbetet e ulët me rreth 4.1 përqind.

Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2019)

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2019, vlera e aseteve të sektorit mikrofinanciar ishte për 17.9 milionë euro më e lartë dhe arriti vlerën në 267.8 milionë euro në mars 2019 (figura 27).

Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues dhe në masë më të ulët aktivitetit të lizingjeve, aktivitete të cilat financohen kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm që përbëjnë 67.6 përqind të gjithsej aseteve. Kurse huazimet në sektorin e brendshëm dhe burimet vetanake përbëjnë 8.5 dhe 23.9 përqind të gjithsej aseteve, respektivisht.


Kreditë

Në TM1 2019, kreditë u rritën për 10.8 milionë euro, kryesisht nga kreditë ndaj ekonomive familjare, të cilat u rritën për 8.5 milionë euro dhe që pjesëmarrja e tyre arrin në 66.5 përqind të gjithsej kredive të sektorit.

Në anën tjetër, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 33.5 përqind të gjithsej kredive të

sektorit, u shtuan për 2.3 milionë euro (figura 28).


Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, ndryshimi vjetor i kredive



Burimi: BQK (2019)

Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, rritje megjithëse më të ngadalësuar, shënuan të gjithë sektorët të ekonomisë, duke veçuar atë të bujqësisë, industrisë, dhe ndërtimtarisë. Rritja më e lartë e kreditimit ishte ndaj sektorit të bujqësisë, që u shtua për 0.8 milionë euro në TM1 2019 (figura 29).

Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve të ekonomisë në TM1




Burimi: BQK (2019)

Për dallim nga sektori bankar, ku kreditimi ndaj bujqësisë është më i kufizuar, për sektorin mikrofinanciar përbën një ndër kategoritë kryesore me përfaqësim prej 26.6 përqind të gjithsej kreditimit ndaj sektorëve të ekonomisë.

Lizingjet

Stoku i lizingjeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 u shtua për 2.3 milionë euro (1.4 milionë euro në TM1 2018) (figura 30).




Në rritjen e vlerës së lizingjeve kontribuoi rritja e lizingut për ndërmarrje, përkatësisht “lizingjeve për paisje” dhe “lizingjeve tjera”.

Normat e Interesit


Normat mesatare të interesit në kredi në tremujorin e parë të vitit 2019 u zvogëlua në 21.5 përqind, nga 23.1 përqind sa ishte në TM1 2018. Me rënie më të theksuar u karakterizuan normat në kredi për ekonomitë familjare (për 2.2 pikë përqindje), kurse ato për ndërmarrje u zvogëluan për 1.6 pikë përqindje (figura 31).

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të ekonomive familjare, norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese shënoi rënien më të theksuar, për 5.8 pikë përqindje, në 22.3 përqind gjatë TM1 2019. Po ashtu, norma mesatare e interesit në kreditë hipotekare gjatë kësaj periudhe u zvogëlua për 4.0 pikë përqindje në 21.6 përqind.

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve vijon të ketë normën më të ulët të interesit, duke zbritur edhe më tutje gjatë TM1 2019 për 2.1 pikë përqindje në 15.7 përqind. Ndërsa, sektori i industrisë mbetet sektori me normën më të lartë të interesit në kredi prej 22.3 përqind, përkundër rënies prej 2.8 pikë përqindje në raport me TM1 2018 (figura 32).


Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar vazhdoi të ketë rezultat pozitiv financiar. Megjithatë, krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraprak, profiti i realizuar në këtë tremujor në vlerë prej 2.2 milionë euro ishte për 0.3 milionë euro më i ulët.

Profiti i realizuar i atribuohet rritjes së të hyrave, e kryesisht rritjes së të hyrave nga interesi të realizuara nga aktivitetit i rritur kreditor dhe i lizingut. Të hyrat e sektorit u rritën për 3.6 milionë euro, ndërsa të hyrat nga interesi për 2.1 milionë euro, kategori që përfaqëson 80.0 përqind të gjithsej të hyrave.

Përderisa, realizimi i profitit në nivel më të ulët se në tremujorin e vitit paraprak reflekton rritjen e shpenzimeve të ndodhura (figura 33).

Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2019)

Shpenzimet e sektorit shënuan rritje prej 3.9 milionë euro krahas TM1 2018 dhe arritën në 10.6 milionë euro në TM1 2019. Rritjen më të lartë e patën shpenzimet nga jo-interesi, të cilat u shtuna për 2.5 milionë euro. Kjo rritje erdhi si rezultat i ndarjes më të lartë të provizioneve për humbjet e mundshme në kredi si rezultat i rritjes së theksuar të stokut të kredive. Po

ashtu, edhe nënkategoria e shpenzimeve të personelit shënoi rritje të konsiderueshme.

Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës
Burimi: BQK (2019)

rezultat i shtimit të numrit të të punësuarve dhe degëve të reja për të operuar.

Rrjedhimisht, treguesit e profitabilitetit të anualizuar për tremujorin përkatës, shënuan rënie (figura 34).

Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK (2019)


Kreditë me probleme shënuan rritje të lehtë, megjithëse raporti i tyre ndaj kredive qëndron në nivel mjaft të ulët dhe janë mjaft mirë të mbuluara me provizione. Kreditë joperformuese në raport me gjithsej kreditë në mars 2019 qëndruan në 2.8 përqind (2.5 përqind në mars 2018). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në mars 2019

arriti në 210.8 përqind, ngjashëm me periudhën paraprake (figura 35).

Tregu i letrave me vlerë

Në tremujorin e parë të vitit 2019, janë emetuar bono dhe fletë-obligacione qeveritare në vlerë prej **105.0 milionë euro**.

Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave

Vlera e emetuar e letrave me vlerë në këtë tremujor ishte 3.1 përqind më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, kurse për 10.5 përqind më e lartë se në tremujorin paraprak (figura 36).


Tabela 1. Numri, shuma dhe norma mesatare e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës

Periudha	Bonot e thesarit			Fletë-obligacionet		
	Numri i ankandëve	Shuma e pranuar	Norma mesatare	Numri i ankandëve	Shuma e pranuar	Norma mesatare
TM1 2016	3	60.0	0.70	3	60.0	2.36
TM1 2017	3	60.0	0.12	1	20.0	0.90
TM1 2018	2	60.0	0.36	2	48.4	1.13
TM1 2019	1	30.0	0.61	3	75.0	2.11

Burimi: Ministria e Financave (2019)

Ecuria e letrave me vlerë të emetuara reflekton kërkesat e Qeverisë së Kosovës, për të financuar projektet e saj kapitale dhe kërkesat e investuesve për të investuar në këtë instrument borxhi. Norma mesatare e interesit në bono të thesarit në TM1 2019 ishte 0.61 përqind, ndërsa në fletëobligacione qeveritare ishte 2.1 përqind.


Figura 37. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2019)

Norma më e lartë e interesit në këtë periudhë mund të jetë ndikuar prej numrit më të lartë dhe shumës më të lartë të emetuar të fletë-obligacioneve, (tabela 1) të cilat kanë norma më të larta të interesit për shkak të maturitetit të gjatë që bartin.

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2019)

Shuma e kërkuar nga pjesëmarrësit në ankand ishte për 1.9 herë më e lartë se shuma e emetuar nga Qeveria (1.3 herë më e lartë në TM1 2018) (figura 37).

Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit po konvergjon drejt afateve më të gjata të maturimit, e dominuar nga fletë-obligacionet qeveritare që përbëjnë 71.4 përqind të gjithsej letrave me vlerë të emetuara në këtë tremujor.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2019): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 26, TM1 2019, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2019):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>

ASK (2019):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

Të tjera (2019):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-qov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2019): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2019): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2018	TM1 2019
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,298.8	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.0%	3.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.1%	3.2%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	352.1	388.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	400.7	382.5
Bilanci primar (në milionë euro)	-48.6	6.1
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,905.3	6,513.1
prej të cilave: Bankat	3,872.8	4,229.1
Kredi	2,534.3	2,824.1
Depozita	3,074.0	3,383.7
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.8%	6.7%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.2%	1.5%
Hendeku i normës së interesit	5.6%	5.2%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-71.9	-95.6
prej të cilave: remitencat e pranuar	108.2	113.0
Llogaria financiare	11.8	41.8
Investimet e huaj direkte në Kosovë	28.8	44.7
Investimet portfolio, net	4.3	-56.0
Investimet tjera, net	-19.0	-13.4
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-115.1	-310.9
Asetet	4,829.9	4,763.4
Detyrimet	4,944.9	5,074.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,088.5	2,011.8
Borxhi i jashtëm privat	1,589.2	1,517.0
Borxhi i jashtëm publik	499.3	498.1

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV për TM1 2019 nuk është publikuar ende.

2/ MF (2019).

3/ BQK (2019).

*Të dhënat për sektorin e jashtëm janë deri në shkurt 2019 ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm deri në dhjetor 2018.

